



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-127569
Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e renovimit të pjesshëm të objektit të Shkollës Filllore të Mesme të Ultë “Heronjtë e Lumës” në fshatin Shkozë, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 14020 -mallra dhe shërbime.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës, Zyra e Prokurimit dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-127573

Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim-trajtim mjekësor të pacientëve të sëmurë me CA:
1. Suzana Bytyqi, 2. Shemsije Kastrati, 3. Arif Shala, 4. Aida Mashkulli, 5. Samile Topojani, 6. Zyber Hajredini, 7. Valid Fazljija, 8. Asip Gashi, 9. Avdije Çela, 10. Aferdita Redza, 11. Xhevahire Zogaj, 12. Sinan Bytyqi, 13. Elide Gashi, 14. Shehije Rama, 15. Nazmi Krasniqi, 16. Valentina Zenunaj.
2. Për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 300 € (treqind euro) për secilin prej të lartpërmendurve.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 2 të këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Komunës së Prizrenit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-127577

Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE

1. Miratohet propozimi i Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit, për Hava Berisha, zyrtare komunale, pran Drejtorisë së Shëndetësisë, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit (diagnoza –cataraeta praescenilis matura), lejohen mjetet financiare në shumën prej 350.00 € (treqind e pesëdhjetë euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfere dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Komunës së Prizrenit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Të lartcekurës,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-127580
Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit për Verica Matiani, e diagnostifikuar me diagnozë: “FOU Fundus hypertonicus OS Opacitates in CV”, kështu që, në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit, lejohen mjetet financiare në shumën prej 350.00 € (treqind e pesëdhjetë euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfere dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Të lartcekurës,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-127581

Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për shënimin dhe organizimin e manifestimit “Java e Rinisë 2017”, i cili manifestim organizohet nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Këshillin e Veprimit Rinor Lokal, Qendrën Rinore-Prizren, Këshilli i nxënësve të shkollave të mesme, OJQ-të rinore, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 2500.00 € (dymijë e pesëqind euro).
2. Aktivitetet që do të organizohen për këtë manifestim janë: Konferencë, gara sportive ekspozita, rok koncert, kampanjë, mbrëmje rinore, etj.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Subjekteve të cekura,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-127583

Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE

1. Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Islam Elshanit, zyrtar komunal, për në Republikën e Gjermanisë, me qëllim të pjesëmarrjes në vizitën studimore lidhur me përfshirjen e aktorëve relevant nga institucionet partnere të projektit rajonal “Përfshirja sociale për grupet në nevojë”. Vizita studimore do të realizohet nga data 25 shtator 2017 deri me 29 shtator 2017, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-127584
Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e furnizimit me pije freskuese për dy bufet e Komunës së Prizrenit (bufen në Shtëpinë e Bardhë dhe në Administratën e Komunës), kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatës.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Administratës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-127586
Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e furnizimit me 500 tonelata kripë industriale për mirëmbajtje dimërore të rrugëve të komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatës.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-127589
Më 12 .09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e bërjes së shqyrtimeve gjeologjike të tokës në fshatin Korishë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatës.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike-mallra dhe shërbime.
3. Ky Vendim është marrë me qëllim që të ndërmerren masat e nevojshme parandaluese për shkak të rrezikimit të banorëve të kësaj pjese nga rrëshqitjet e mëdha të dheut, andaj nevojiten informata (ekzaminime inxhinierike) të nevojshme.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është specifikacioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-127592
Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e renovimit të dyshemeve të korridorëve të objektit të Gjinnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.
2. Ky projekt (renovimi i dyshemeve të korridorëve) realizohet nga buxheti vetanak i Gjinnazit “Gjon Buzuku” dhe Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Gjinnazi “Gjon Buzuku”, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-127595
Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), të Planit Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme në Komunën e Prizrenit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës me 12 shtator 2017, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për monitorimin e implementimit të Planit të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme për periudhën 2017-2018

1. Emërohet Komisioni për monitorimin e implementimit të Planit të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme për periudhën 2017-2018, në përbërje prej:
 - 1.1. Reshit Kushaj, nga DKA, kryesues,
 - 1.2. Idbalka Fazlija –Rama, nga ZKK, dhe
 - 1.3. Eleonora Bush-Fetollari nga ZIE.
2. Komisioni është përgjegjës për monitorimin e implementimit të Planit të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme konformë dispozitave ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse për periudhën 2017-2018.
3. Obligohet Komisioni që për punën e tij çdo 6 (gjashtë) muaj ti raportoj me shkrim kryetarit të Komunës duke përfshirë edhe rekomandimet në lidhje me implementimin e këtij plani.
4. Anëtarët e këtij komisioni duhet të bashkëpunojnë me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe organe tjera relevante.
5. Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Komisioni i lartcekur.
7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Të gjitha drejtorive,
- Të emëruarve,
- Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-127597
Më 12.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës më 12 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e vendosjes së shenjzimit horizontal (vendosja e vijave të bardha orientuese) në rrugë në territorin e komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatës.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike-mallra dhe shërbime.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-130722
Më 18.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës më 18 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e realizimit të projektit: "Shtimi i kapaciteteve të ujit të pijes në fshatin Zhur"-faza e dytë, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatës.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 40635.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive.
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja,



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-130727

Më 18.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës më 18 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të 4 (katër) rrugëve lokale në lagjen 11 Marsi në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatës.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 43343.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadin Muja





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-130732
Më 18.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës më 18 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim-trajtim mjekësor të pacientëve të sëmurë me CA:
 - 1.1. Rrushe Mazreku,
 - 1.2. Kadir Potokciya,
 - 1.3. Dijar Fishekqi,
 - 1.4. Ismet Lalosh,
 - 1.5. Jon Gashi.
2. Për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 300 € (treqind euro) për secilin prej të lartpërmendurve.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 2 të këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Komunës së Prizrenit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Raifadon Muja





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-130739
Më 18.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, më 18 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e mjeteve financiare për participim (bashkëfinancim) në realizimin e projektit: “Konservimi dhe gërmime arkeologjike” në kalanë e “Gralishtes” në fshatin Korishë”, i cili participim është i bazuar në memorandumun e dytë të bashkëpunimit të nënshkruar në mes të Komunës së Prizrenit dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës, kështu që, për këtë qëllim, Komuna e Prizrenit lejon mjetet financiare në shumë prej 19.600 € (nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind euro), përkatësisht participon me 49% të mjeteve nga shuma e përgjithshme e vlerës së projektit.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit të nënshkruar në mes të Komunës së Prizrenit dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës nr. 01-132/17 të datës 02.8.2017.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni buxhetor nr. 43396 i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik i planifikuar për këtë qëllim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - IAK,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-130745
Më 18.09.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13, nenit 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, kryetari i Komunës më 18 shtator 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, për lejimin e rekrutimit (pranimit) të disa nëpunësve, për kryerjen e shërbimeve të veçanta në Komunën e Prizrenit në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa –Sektorin e Tatimit në Pronë, për kohë të caktuar përkatësisht për 6 (gjashtë) muaj, kështu që, për këtë qëllim, lejohet zhvillimi i procedurave ligjore për rekrutimin dhe pranimin e 8 (tetë) nëpunësve për kryerjen e shërbimeve të lartcekura.
2. Nëpunësit që do të pranohen, në bashkëpunim me personat kompetent të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, do të angazhohen kryesisht në inkasimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë, taksat komunale dhe punë të tjera, konform ligjit dhe akteve tjera nënligjore.
3. Nëpunësit që do të pranohet për këtë qëllim duhet të jenë jurist, ekonomistë, etj.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Zyra e Personelit.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Personelit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

